

Vendim nr. 3 datë 08.01.2025

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Ilir Toska,	Anëtar

në datën 08.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 16 (I) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ILIR MUZHAQI

OBJEKTI: Cenimi i së drejtës së aksesit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

BAZA LIGJORE: Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ilir Muzhaqi është arrestuar në flagrancë si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi”, më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 143, pika 2, i Kodit Penal (*KP*).

2. Me vendimin e datës 12.10.2023 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur të vleftësojë të ligjshëm arrestin në flagrancë të kërkuesit dhe

caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, të parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale (KPP). Ky vendim është miratuar nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm me vendimin nr. 1937, datë 24.10.2023.

3. Me vendimin e datës 04.06.2024 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka pranuar kërkesën e datës 10.04.2024 të prokurorisë, duke dërguar për gjykim procedimin penal nr. 663 të vitit 2023 me të pandehur kërkuesin, i akuzuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi” më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 143, pika 2, i KP-së.

4. Në datën 06.06.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm me ankim, me objekt shuarjen e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” për shkak të humbjes së fuqisë së kohëzgjatjes së paraburgimit, bazuar në nenet 249, pika 9, 250, pika 1, 262, pika 1 dhe 263, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së. Sipas kërkuesit, shkak i kërkesës është tejkalimi i afateve kohore, pasi efektet e paraburgimit kanë filluar të ecin nga data e arrestimit të tij, 09.10.2023 dhe ato duhet të përfundonin më 09.04.2024, sipas nenit 263, pika 1, shkronja “b”, të KPP-së, pasi deri në atë datë atij nuk i është komunikuar asnjë aktgjyqim për veprimet e organit të akuzës ose të gjykatës kompetente.

5. Me shkresën e datës 10.06.2024 gjykata e apelit i ka dërguar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kërkesën e kërkuesit për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, të dhënë me vendimin e datës 12.10.2023 të gjykatës së shkallës së parë, pasi nga verifikimi i kryer nuk ka rezultuar që në gjykatë të ishte regjistruar një çështje penale që i përket atij vendimi. Kjo shkresë i është komunikuar edhe kërkuesit.

6. Pasi është njohur me këtë shkresë kërkuesi i është drejtuar sërish gjykatës së apelit me aktin “Sqarim ankimi”, duke parashtruar se ankimi i datës 06.06.2024 është paraqitur në atë gjykatë si ankim i drejtpërdrejtë, në mbështetje të nenit 249, pika 9, të KPP-së dhe jo si ankim ndaj një vendimi të gjykatës së shkallës së parë, duke kërkuar gjykimin e tij nga gjykata e apelit.

7. Ndërkohë, pas regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me vendimin e datës 12.06.2024, ajo gjykatë ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, me arsyetimin se është e pabazuar në ligj. Sipas asaj gjykate, kërkuesi është duke konsumuar afatet e paraburgimit që i përkojnë fazës së gjyqimit, pasi aktet janë depozituar në gjykatë prej datës 18.04.2024 dhe jo vetëm që nuk është vërtetuar ndonjë rrethanë që e kthen çështjen në fazën e hetimit, por rezulton e provuar se është

pranuar kërkesa për dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas asaj gjykate, në fazën në të cilën ndodhet procedimi për kohëzgjatjen e afateve të paraburgimit zbatohet shkronja “b” e pikës 2 të nenit 263 të KPP-së, pra afati 9-mujor që nuk konstatohet të ketë përfunduar. Në vlerësimin e gjykatës, pretendimet dhe kërkimet për tejkalimin e afatit të paraburgimit të fazës së hetimit paraprak me pasojë heqjen/shuarjen e masës do të duhej të ishin adresuar në fazën e duhur procedurale, pa filluar zbatimi i afateve të paraburgimit që i përkasin fazës së gjykimit dhe se në kushtet që ndaj kërkuesit aplikohen aktualisht afatet e paraburgimit gjatë fazës së gjykimit, gjykata nuk mund të vlerësojë veprimet që lidhen me kalimin e afateve të paraburgimit në fazën e hetimit paraprak.

8. Në datën 16.07.2024 në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, mbi bazën e ankimit të kërkuesit, është regjistruar çështja e tij për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”.

9. Në datën 16.07.2024 gjyqtarja relatores ka caktuar zhvillimin e seancës në datën 23.07.2024, si dhe ka urdhëruar edhe shoqërimin e të pandehurit Ilir Muzhaqi. Ky i fundit ka lëshuar një deklaratë në prani të nëpunësit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fushë-Krujë, ku deklaron se nuk ka akt njoftimi për arsyet e thirrjes dhe objektin e gjykimit. Në seancën gjyqësore të datës 23.07.2024, referuar procesverbalit të saj, gjykata ka konstatuar se kërkuesi nuk ishte i pranishëm dhe se ai ka paraqitur deklaratë se nuk do të paraqitet, pasi nuk ka akt njoftim. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit, me vendimin nr. 1714/30-2024-5869, datë 23.07.2024, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të datës 12.06.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, duke e gjetur të drejtë arsyetimin e vendimit objekt ankimi. Ky vendim, me dëftesën e komunikimit të datës 08.10.2024, rezulton t'i jetë komunikuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për kërkuesin Ilir Muzhaqi.

10. Në datat 27.08.2024 dhe 27.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për informacion në lidhje me kërkesën e tij të datës 06.06.2024 drejtuar asaj gjykate.

11. Në datën 30.10.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 18.11.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

12. **Kërkueti**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta e aksesit në gjykatë për shkak se edhe pse ai i është drejtuar Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me ankimin e datës 06.06.2024 për shuarjen e masës së sigurimit “Arresti në burg”, në mbështetje të nenit 249, pika 9, të KPP-së, ajo gjykatë nuk ka ndërmarrë veprime njoftuese për thirrjen e kërkuetit, nuk ka regjistruar ankimin dhe as nuk ka krijuar dosje gjyqësore. Po kështu, ajo gjykatë nuk u ka kthyer përgjigje as kërkesave të kërkuetit të datave 27.08.2024 dhe 27.09.2024. Për rrjedhojë, kërkueti ndodhet në kushte izolimi për shkak të mosveprimit të gjykatës së apelit, së cilës i është kërkuar verifikimi i normave procedurale penale të parashikuara si garanci për të drejtat e të dyshuarit/pandehurit përgjatë shqyrtimit në fazën e hetimeve dhe asaj gjyqësore, sipas shkaqeve të parashtruara në aktin “Ankim” të datës 06.06.2024 dhe aktin “Sqarim Ankimi” të datës 18.06.2024.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuetit

13. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kolegji vlerëson se kërkueti, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, për sa kohë ai është pala që ka vënë në lëvizje

gjykatën e apelit me kërkesë për shuarjen e masës së sigurimit personal të dhënë ndaj tij, për të cilën pretendon se nuk është marrë në shqyrtim prej saj në kundërshtim me të drejtën e aksesit, si element i së drejtës kushtetuese për proces të rregullt, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e paraqitur.

15. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor.

16. Kolegji vëren se ndaj kërkuesit është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest në burg”, si i dyshuar për kryerjen e veprës penale “Mashtrimi” më shumë se një herë, të parashikuar nga neni 143, pika 2, i KP-së. Mbi bazën e kërkesës së prokurorisë, çështja penale në ngarkim të kërkuesit është dërguar për gjykim në gjykatë. Kërkuesi, duke pretenduar se paraburgimi ka humbur fuqinë, i është drejtuar drejtpërdrejt Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë me ankim, me objekt shuarjen e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, si gjykata kompetente, në kuptim të përmbajtjes së nenit 249, pika 9, të KPP-së. Gjykata e apelit, pasi ka konstatuar se në atë gjykatë nuk kishte të regjistruar një çështje penale që i përket vendimit të caktimit të masës së sigurimit ndaj kërkuesit, e ka dërguar kërkesën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, e cila, pasi e ka marrë në shqyrtim atë, me vendimin e datës 12.06.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, si të pabazuar në ligj. Ky vendim është lënë në fuqi edhe nga gjykata e apelit, e vënë në lëvizje mbi ankimin e kërkuesit.

17. Kolegji vëren, gjithashtu, se si shkresa e gjykatës së apelit për dërgimin e kërkesës për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe njoftimi për datën e seancës në këtë të fundit, u janë komunikuar kërkuesit dhe ai ka marrë dijeni për to, siç ka parashtruar edhe në ankimin kushtetues individual drejtuar Gjykatës. Nga ana tjetër, edhe vendimi i gjykatës së apelit që ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë për rrëzimin e kërkesës për shuarjen e masës së sigurimit rezulton t`i jetë komunikuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për kërkuesin Ilir Muzhaqi dhe ai nuk ka ngritur ndonjë pretendim në këtë drejtim, pra për marrjen dijeni për këtë vendim ose për datën në të cilën i është komunikuar ai vendim.

18. Bazuar në faktet e mësipërme, si dhe referuar thelbit të pretendimeve të kërkuesit, Kolegji vëren se pretendimet e tij të parashtruara në ankimin e drejtpërdrejtë drejtuar gjykatës së

apelit në datën 06.06.2024, që kanë të bëjnë me shuarjen e masës së sigurimit, janë marrë në shqyrtim nga gjykatat e zakonshme të faktit, konkretisht nga gjykata e shkallës së parë, e cila i ka dhënë atij përgjigje të arsyetuar për shkaqet e parashtruara në mbështetje të kërkesës dhe, mbi bazën e ankimit të kërkuarit, edhe gjykata e apelit, e cila ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Kolegji vëren, gjithashtu, se referuar kërkesës dhe akteve bashkëlidhur asaj, ashtu edhe të dhënave të publikuara në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, deri në momentin e shqyrtimit të kësaj kërkesë nuk rezultojnë që kërkuari t'i jetë drejtuar asaj gjykate me rekurs kundër vendimeve gjyqësore që kanë rrëzuar kërkesën e tij për shuarjen e masës së sigurimit personal, mjet juridik me të cilin ai mund të ngrejë pretendime edhe në drejtim të së drejtës së aksesit referuar mënyrës se si gjykatat e zakonshme kanë interpretuar dispozitat procedurale penale në lidhje me kompetencën e tyre për shqyrtimin e kërkesës së tij, duke pasur më pas edhe të drejtën për të ngritur të tilla pretendime në lidhje me procesin gjyqësor edhe në këtë Gjykatë. Kërkuari i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykatën e apelit në lidhje me shqyrtimin e një kërkesë për të cilën jo vetëm që ka marrë përgjigje nga gjykatat e zakonshme të faktit, por edhe në situatën kur ai ka mjete juridike efektive në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij (rekursi në Gjykatën e Lartë), të cilat, në kuptim të kriterit të shterimit, duhet t'i përdorë ose, në të kundërt, duhet të argumentojë dhe provojë se përdorimi i tyre nuk do të ishte efektiv në rastin e tij, çka nuk ka ndodhur në rastin konkret. Në këto kushte, arrihet në përfundimin se kërkuari nuk plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike për t'iu drejtuar Gjykatës.

19. Në këndvështrim të sa më lart, duke qenë se kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë kumulative, Kolegji çmon të mos ndalet në analizën e mëtejshme të plotësisimit të kriterëve të tjera të legjitimitetit të kërkuarit.

20. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.